

# Shërbimet Pride Health NYC Health + Hospitals

Një mjedis kujdesi shëndetësor i sigurt  
dhe mikpritës për individët LGBTQ+



Care for NYC. No Exceptions.

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**



## NE JEMI ALEATË

NYC Health + Hospitals është i përkushtuar që t'u japë njujorkezëve që janë lezbikë, gej, biseksualë, transgjjinorë dhe queer+ (LGBTQ+) mundësinë për të bërë një jetë sa më të shëndetshme. Sistemi ynë shëndetësor ofron kujdes të shpejtë, të dhembshur dhe respektues në një mjedis mikpritës. Ne kemi një qasje të përqendruar te pacienti drejt sigurimit të aksesit kuptimplotë, pavarësisht gjuhës së folur apo statusit të emigracionit. Ofrohen shërbime përkthimi me gojë.

Si aleat, ne mbështesim të drejtat civile dhe barazinë shëndetësore LGBTQ+. Institucionet tona kanë të drejta të hapura vizitash për të gjithë pacientët LGBTQ+ dhe familjet e tyre — dhe ne kemi tolerancë zero kundrejt diskriminimit të bazuar në orientimin seksual, identitetin ose shprehjen gjinore.

## KUJDES SHËNDETËSOR I PËRSHTATUR PËR JU

Ne e kuptojmë që, si anëtar i komunitetit LGBTQ+, ju keni nevoja dhe shqetësime unike që lidhen me kujdesin shëndetësor. Shërbimet tona Pride Health ofrojnë kujdes shëndetësor konfirmues për banorët LGBTQ+ të Nju Jorkut. **Ofruesit e këtyre shërbimeve kanë marrë trajnim të gjerë për t'u siguruar që të ofrojnë kujdes sipas kulturës.** Klinikët tanë janë këtu për t'iu përgjigjur nevojave tuaja shëndetësore dhe të gjitha pyetjeve tuaja në një mjedis të sigurt dhe mikpritës.

## SHËRBIMET TONA

- + Kujdesi parësor, i cili përfshin vaksinimet, terapinë hormonale dhe referimet kirurgjikale
- + Shërbime dhe referime të shëndetit të sjelljes
- + Profilaksia para ekspozimit (Pre-exposure prophylaxis, PrEP)
- + Profilaksia pas ekspozimit (Post-exposure prophylaxis, PEP)
- + Testimi dhe trajtimi i HIV-it
- + Testimi dhe trajtimi i infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST)
- + Navigimi dhe regjistrimi i sigurimeve
- + Bllokues të pubertetit në Elmhurst, Jacobi, Judson dhe Metropolitan
- + Kujdesi konfirmues obstetrikogjinekologjik në Bellevue, Elmhurst, Gouverneur, Jacobi dhe Lincoln; Vetëm kujdes gjinekologjik në Judson, Metropolitan dhe Woodhull





Ne ofrojmë gjithashtu **kirurgji që konfirmojnë gjininë** në:

### **Elmhurst**

- + Histerektomi, Ooforektomi, Zgjerim i mollëzave, Gjenioplastikë, Riformësim i kockave frontale, Ngritje e vetullave frontale, Ulje e vijës së flokëve, Rezekcion këndor

### **Lincoln**

- + Implante të gjoksit, Rritje të gjoksit, Mastektomi, Reduktim të gjoksit, Histerektomi, Ooforektomi, Septoplastikë, Gjenioplastikë, Riformësim i kockave frontale, Ngritje e vetullave frontale, Rivendosje e sinuseve frontale, Ulje e vijës së flokëve

### **Jacobi**

- + Histerektomi, Ooforektomi

### **Metropolitan**

- + Implante të gjoksit, Rritje të gjoksit, Mastektomi, Reduktim të gjoksit, Histerektomi, Ooforektomi, Zgjerim i mollëzave, Septoplastikë, Gjenioplastikë, Riformësim i kockave frontale, Ngritje e vetullave frontale, Rivendosje e sinuseve frontale, Ulje e vijës së flokëve, Rinoplastikë, Rruajtje trakeale, Rezekcion këndor

Për të mësuar më shumë rreth shërbimeve LGBTQ+, skanoni kodin QR në faqen mbrapa.

## Pikat:

### Brooklyn

#### NYC Health + Hospitals/Woodhull

Mosha e pacientit: Të rritur (18+)  
760 Broadway, Room 2B-151 (Main Floor)  
Brooklyn, NY 11206  
Telefon: 718-963-8301  
Email: valerie.santangelo@nychhc.org

### Bronx

#### NYC Health + Hospitals/Jacobi

Mosha e pacientit: Të gjitha moshat  
1400 Pelham Parkway South, Building 8  
1st Floor, Suite 1D, Bronx, NY 10461  
Telefon: 718-918-7787

#### NYC Health + Hospitals/Lincoln

Mosha e pacientit: Të rritur (18+)  
234 East 149th Street, 8th Floor, Suite 8A  
Bronx, NY 10451  
Telefon: 718-579-5264

### Manhattan

#### NYC Health + Hospitals/Bellevue

Mosha e pacientit: Të rritur (18+)  
462 First Avenue, New York, NY 10016  
Telefon: 332-259-0404

#### NYC Health + Hospitals/Gotham Health, Gouverneur

Mosha e pacientit: Të rritur (18+)  
227 Madison Street, 2nd Floor  
New York, NY 10002  
Telefon: 212-441-5469  
Email: gouvlgbtq@nychhc.org

#### NYC Health + Hospitals/Gotham Health, Judson

Mosha e pacientit: Mosha 11 vjeç e lart  
34 Spring Street, New York, NY 10012  
Telefon: 212-925-5000, opsioni 2

#### NYC Health + Hospitals/Metropolitan

Mosha e pacientit: Të gjitha moshat  
1901 First Avenue, OPD Building  
1st Floor, New York, NY 10029  
Telefon: 212-423-7292  
Email: metlgbt@nychhc.org

### Queens

#### NYC Health + Hospitals/Elmhurst

Mosha e pacientit: Të gjitha moshat  
7901 Broadway, Elmhurst, NY 11373  
Telefon: 718-334-LGBT (718-334-5428)  
Email: elmhurstPRIDE@nychhc.org

# Kujdesi për NYC. Pa përjashtime.

Skanoni për të mësuar më shumë  
rreth shërbimeve tona.



PARTNERS IN  
LGBTQ+ CARE



QËNDRONI TË INFORMUAR. NA NDIQNI.

[nychealthandhospitals.org](https://nychealthandhospitals.org)

[LGBTQ@nychhc.org](mailto:LGBTQ@nychhc.org)